



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.1/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi kryesues, Violeta Husaj Rugova, dhe Hajriz Hoti, anëtarë, duke vendosur me ankesën e parashtruar nga Subjekti Politik Socijal Demokratska Unija (SDU), parashtruar kundër Vendimit Nr.01/3394/2025 datë 24.11.2025 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për miratimin e formulës për përbërjen e Anëtareve të Komisioneve Komunal të Zgjedhjeve-KKZ, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahet më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 27.11.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZP.Anr.1/2025 datë 25.11.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Socijal Demokratska Unija (SDU), me të cilën ka kërkuar që të obligoj Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, që të anuloi vendimin Nr.01/3394/2025 datë 24.11.2025, për miratimin e formulës për përbërjen e Anëtareve të Komisioneve Komunal të Zgjedhjeve-KKZ, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 25.11.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga Subjekti Politik Socijal Demokratska Unija (SDU), parashtruar kundër Vendimit Nr.01/3394/2025 datë 24.11.2025, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me të cilën pretendojnë se Komisioni Qendror Zgjedhor ka kryer shkelje të procedurës zgjedhore duke mos e përfshirë përfaqësuesin e subjektit politik SDU në përbërjen e Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ), si parti parlamentare. Tutje, kanë theksuar se SDU në shkurt të vitit 2025 kishte një përfaqësues të emëruar në KKZ-në e Prizrenit, gjë që e dëshmon se KQZ-ja në atë kohë e njihte zyrtarisht statusin e SDU së si parti parlamentare, në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe vendimet përkatëse. Megjithatë, me datë 24.11.2025, KQZ-ja dërgoi një email në të cilin e klasifikon gabimisht SDU-në në grupin e subjekteve që “nuk e kanë kaluar pragun zgjedhor”, duke i mohuar kështu në mënyrë të paligjshme SDU-së të drejtën e pjesëmarrjes në KKZ-në në Prizren, ashtu që si pasoje KQZ-ja i caktoi SDU-së, vetëm një vend në komunën e Dragashit, gjë që është në kundërshtim me praktikën e mëparshme dhe legjislacionit në fuqi. Tutje, kanë theksuar se KQZ-ja, nuk ka autoritet ligjor për të ndryshuar në mënyrë arbitrare statusin e një subjekti politik, as për të përjashtuar një parti parlamentare nga një KKZ në një komunë, veçanërisht kur SDU-ja, e ka pasur këtë të drejtë në të njëjtin vit zgjedhor.

Në përgjigjen në ankesë dërguar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kane deklaruar se bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr.08/L-228 neni 67 par.3 shprehimisht thuhet se KQZ, duhet të përpiqet të garantojë përfaqësimin e drejtë në KKZ, për të gjitha komunitetet, me numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen gjinore. KQZ me datë 24.11.2025 me vendimin nr.01/3394-2025 për Miratimin e Formulës për përbërjen për Anëtar të Komisioneve Komunale Zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Tutje në ankesë thuhet se KKZ-ja përbëhet nga Zyrtari Ekzekutiv i KKZ-së, i punësuar nga KQZ-ja, i cili njëkohësisht ushtron funksionin e kryesuesit të KKZ-së, dhe nga një anëtar i nominuar nga secili subjekt politik që ka kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet nacionale, nëse këto i nënshtrohen pragut zgjedhor. Duke u bazuar në parimin e përfaqësimit, subjekteve dhe koalicioneve që kanë kaluar pragun zgjedhor u takon nga një anëtar në të tridhjetet të Komisionet Komunale të Zgjedhjeve. Në përgjigje në ankesë tutje theksojnë se subjekti politik Socijal Demokratska Unija (SDU), është i përfaqësuar në këtë mekanizëm zgjedhor në komunën e Dragashit. Subjekti i lartë cekur ka theksuar se vendimi i KQZ-së, është në kundërshtim me praktikën e mëparshme gjë e cila nuk qëndron pasi që edhe në përbërjen e Komisioneve Komunale Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025 e miratuar me datë 11.06.2025 me nr. të vendimit 01/1106-2025 subjekti SDU ka pasur përfaqësim në Komunën e Dragashit ashtu siç i takon dhe i njëjti subjekt nuk e ka atakuar vendimin e lartcekur. Tutje kanë theksuar se në e-mailin e datës 24.11.2025 ora 19:09 në ftesën e dërguar subjektin politik për nominim në të cilën subjekti politik duke u bazuar në parimin e përfaqësimit, Socijal Demokratska Unija (SDU), ju takon nga një anëtar në KKZ.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës së parashtruar nga ankuesi, gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli e vlerësoj lejueshmërinë e ankesës dhe ka ardhur në përfundim se e njëjta i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 69 paragraf 7 të Ligjit për Zgjedhjet e përgjithshme, dhe nenin 4 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e parashtrimit dhe vendosjes së ankesave.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ-së, lidhur me mos emërimin e anëtarëve nga radhët e subjektit politik SDU, si anëtar i KKZ-së në Komunën e Prizrenit nuk qëndrojnë, kjo duke u bazuar edhe në dispozitat ligjore të nenit 67 par. 1, nen par. 1.2 të Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se *“nga një (1) anëtarë i nominuar nga subjektet politike që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet nacionale, nëse i nënshtrohen pragut zgjedhor”*, ndërsa në nenin 67 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, në mënyrë decitive thuhet se *“KQZ-ja duhet të përpiqet ta garantojë përfaqësimin e drejtë në KKZ për të gjitha komunitetet, me numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen gjinore”*.

Mbi këtë bazë Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit nr.01/3394/2025 datë 24.11.2025, drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 67 par. 1, nen par. 1.2 dhe par. 3 të Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, sepse subjekti politik Socijal Demokratska Unija (SDU), është i përfaqësuar në KKZ-të në komunën e Dragashit me një anëtar. Përbërja e KKZ-ve, është bërë bazuar në nenin 67 të Ligjit Nr. 08/L –

228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren Zgjedhore 02/2024 Emërimi, Përbërja dhe Funksionimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve të KQZ-së, në bazë të Formulës për emërimin e KKZ-ve, si dhe duke u bazuar në kriteret e Rezultatet e Zgjedhjeve të datës 9 shkurt 2025 në nivel qendror, dhe nivel komunal dhe të dhënat nga raporti i Agjencisë së Statistikave të Kosovës nga Regjistrimi i Popullsisë 2024, ku në nenin 2 par.1 të Rregullores 02/2024 Emërimi, Përbërja dhe Funksionimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve ndër të tjera thuhet se “...se KQZ vendos në bazë të numrit të banorëve dhe numrit të votave të atij subjekti politik në komunën përkatëse”.

Duke marrë për bazë të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të karta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Prandaj, nga arsyet e parashtruara më lart dhe në pajtim me nenin 13 paragrafi 2 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2025, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, si dhe nenit 119 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e refuzuar ankesën si të pabazuar.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.1/2025 datë 27.11.2025



KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.